

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
BORDI I ADMINISTRIMIT

3380
Nr. 3380/prot.

Tiranë, më 13.11.2023

VENDIM
Nr. 70, datë 13.11.2023

“PËR MIRATIMIN E RELACIONIT PËR BASHKËFINANCIM TË PROJEKTIT ME TITULL “DIGJITALIZIMI I DISEKSIONIT VIRTUAL DHE RISTRUKTURIMI I NJËSISË LABORATORIKE TË ANATOMISË” DHE PROJEKTIT ME TITULL “DIGJITALIZIMI I NJËSISË LABORATORIKE TË HISTOLOGJISË” NË KUADËR TË NDËRKOMBËTARIZIMIT TË PROGRAMEVE TË STUDIMIT, PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024”

Në bazë të ligjit nr. 80, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Urdhërit nr.287, datë 07.06.2023 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për shpalljen e thirrjes për financim e IAL-ve Publike për projektet e përbashkëta në kuadër të ndërkombëtarizimit të programeve të studimit, për vitin akademik 2023-2024”, Urdhrit nr. 348, datë 10.07.2023 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për financim/bashkëfinancimin e projekteve të përbashkëta në kuadër të ndërkombëtarizimit të programeve të studimit, për vitin akademik 2023-2024”, Vendimit të Dekanatit të Fakultetit të Mjekësisë nr. 4, datë 25.09.2023, si dhe Vendimit të Rektoratit të UMT-së nr. 14, datë 25.09.2023, Bordi i Administrimit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, pasi mori në shqyrtim Relacionin e përcjellë me shkresën e Administratorit të UMT-së nr. 2000/13 prot., datë 03.10.2023, në mbledhjen e datës 13.11.2023,

VENDOSI:

1. Të miratojë Relacionin e Administratorit të UMT-së nr. 2000/13 "Për pjesën takuese të bashkëfinancimit në vlerën 8 020 000 (tetë milion e njëzetë mijë) lekë" për projektin me titull “Digjitalizimi i Diseksionit Virtual dhe Ristrukturimi i Njesisë Laboratorike të Anatomisë” dhe projektin me titull “Digjitalizimi i njesisë laboratorike të Histologjisë”, në kuadër të ndërkombëtarizimit të programeve të studimit për Fakultetin e Mjekësisë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë.
2. Efekti financiar mbulohet nga të ardhurat e veta, pjesë e buxhetit vjetor të miratuar në zërin “Kërkim shkencor” për Fakultetin e Mjekësisë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administratori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të UMT-së.

**KRYETAR
ZAMIRA GJINI**

ANËTARË

MONIKA FIDA

VERA OSTRENI

ALTINA XHAFERI

ALBANA GJINOPULLI

ANIS THODHORJANI

ENDRIT YZEIRAJ